

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2019

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit në nxitjen e standardeve më të larta në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, si dhe rolin proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti të grupeve më të marginalizuara në shoqëri;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit në transparencën e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;

Duke nënvizuar rëndësinë e rekomandimeve të këtij institucioni për respektimin e të drejtave të njeriut nga administrata publike, si dhe rolin e vet Kuvendit në ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet në nivel qendror dhe vendor;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit në përmirësimin e legjislacionit nga këndvështrimi i standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe bazuar në gjetjet e hetimeve administrative të tij;

Duke vlerësuar rolin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit në promovimin e këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të gjithë territorin ku këto zyra ushtrojnë veprimtarinë e tyre;

Duke risjellë në vëmendje vendimin nr. 134/2018, të Kuvendit të Shqipërisë, për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj;

Bazuar në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2019, në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë së datës 30.5.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018”,

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2019 konstaton se:

1. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019 janë përmbushur në përgjithësi, me përjashtim të dy rekomandimeve që janë në proces.

2. Publikimi i rekomandimeve të tij të nxjerra në vite, adresimi në platformën *online* të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe informimi i këtij të fundit për zbatimin e tyre nuk ka përfunduar ende.

3. Raporti nuk përmban të dhëna të plota për zbatimin e rekomandimit për bashkëpunimin me organet homologe në mbrojtje të të drejtave të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit.

4. Numri i kërkesave dhe ankesave të trajtuara nga Avokati i Popullit është ulur në krahasim me vitin 2018 dhe vetëm 33,4 për qind e tyre ishin brenda juridiksionit të tij.

5. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në kuadër të parandalimit të dhunës dhe torturës, ka inspektuar institucione të paraburgimit dhe burgje, njësi policore, spitale psikiatrike, qendra ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit, viktimat e trafikimit, pika të kalimit kufitar dhe mjediset e planifikuara për të ndërtuar qendrat e trajtimit të përkohshëm të emigrantëve.

6. E drejta e pronës dhe trajtimi i rasteve konkrete ka qenë në fokus të punës së tij.

7. Trajtimi i ankesave, kërkesave dhe kryesisht i rasteve me iniciativë, me objekt të drejtat e fëmijëve, ka pasur një vëmendje të veçantë të tij.

8. Angazhimi në çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe komunitetin LGBTI është rritur.

9. Numri i rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike dhe të zbatuara ka njohur rritje në krahasim me vitin 2018. Nga 213 rekomandime të adresuara organeve në nivel qendror dhe vendor, 63 për qind e tyre janë pranuar, 23 për qind janë në proces zbatimi, 10 për qind janë refuzuar dhe 4 për qind janë pa përgjigje.

10. Numri i ankesave/kërkesave të adresuara në zyra vendore është rritur dhe ato përbëjnë 44 për qind të numrit të përgjithshëm të kërkesave të drejtuara gjatë vitit 2019. Zyra vendore në Bashkinë Fier është mbyllur dhe është hapur zyra e re në Bashkinë Vlorë.

Bazuar sa më sipër, për vitin 2020, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Avokati i Popullit:

1. Të përfundojë procesin e hedhjes së të dhënave për rekomandimet e adresuara, të përditësojë të dhënat në kohë reale, si dhe të ndjekë në mënyrë sistematike zbatimin e rekomandimeve të adresuara.

2. Të marrë masa për pasqyrimin e plotë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve të pushtetit ekzekutiv, organeve në nivel qendror dhe vendor në Platformën Ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të pasqyrojë statusin e realizimit të tyre në Platformën Ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

3. Të rrisë angazhimin në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, që banojnë jashtë vendit, duke rritur bashkëpunimin me institucionet homologe.

4. Të gjejë mekanizmat e duhur për një informim gjithëpërfshirës të shtetasve në lidhje me kompetencat dhe natyrën e kërkesave/ankesave, që mund të adresohen në këtë institucion.

5. Të rrisë angazhimin në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërmarrë nisma konkrete në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë sistematike për nismat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në fushën e të drejtave të njeriut.

6. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të raportojë në kohë Kuvendin e Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.

7. Të rrisë angazhimin konkret në monitorimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, të barazisë gjinore, të drejtat e pakicave kombëtare dhe komunitetit LGBTI, si dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë, në mënyrë periodike, për gjetjet dhe sugjerimet përkatëse për adresimin e problemeve të konstatuara.

8. Të rishikojë strukturën dhe organikën e institucionit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe objektivave institucionalë, në mënyrë që të adresohen problematikat për kryerjen e detyrave funksionale me efektivitet dhe në përmbushje të rekomandimeve evropiane për organet e barazisë.

9. Të përmirësojë aplikacionin “Avokati i Popullit” për të rritur efektivitetin e tij, si dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre.

10. Të ndërmarrë hapa konkretë për informimin e qytetarëve, për kompetencat e Avokatit të Popullit, në nivel qarku ku funksionojnë zyrat, nëpërmjet zhvillimit të sesioneve informuese/ndërgjegjësuere, duke angazhuar punonjësit e zyrave rajonale, me fokus grupet e shtresat e marginalizuara, të cilat nuk kanë aksesin e duhur në informacion e nevojshëm për mekanizmat e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

11. Të raportojë në mënyrë periodike në Kuvendin e Shqipërisë për natyrën e kërkesave/ankesave të adresuara në nivel vendor.

12. Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në manualin e miratuar me vendimin nr. 134/2018 “Për miratimin e Manualit të

Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj” dhe detyrimisht të përmbajë raportimin e veprimtarisë së secilit komisioner të tij.

Miraturar në datën 9.7.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi